


# NUK KA VEND



për gjuhë të  
urrejtjes në  
internet

# NUK KA VEND PËR GJUHË TË URREJTJES NË INTERNET

Broshurë për edukimin e të rinjve rreth  
gjuhës së urrejtjes në internet

**Autorë:**

Fjolla Gorri  
Shkodran Ramadani

**Editor:**

Teuta Zymeri

**Dizajni:**

Envinion

Shkrimet dhe mendimet e autorëve nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën ose pozicionin zyrtar të SIDA-s ose qeverisë suedeze.



# PËRMBAJTJA

<b>Hyrje .....</b>	<b>5</b>
<b>1. Liria e Shprehjes.....</b>	<b>6</b>
1.1. Standardet ligjore ndërkombëtare.....	7
1.2. Standardet ligjore të Kosovës .....	7
<b>2. Gjuha e urrejtjes .....</b>	<b>9</b>
2.1. 5 Arsyejt pse duhet t'na interesojë gjuha e urrejtjes ....	13
<b>3. Format e gjuhës së urrejtjes.....</b>	<b>14</b>
3.1. Stereotipet, Paragjykimet, Diskriminimi .....	14
3.2. Bullizmi në internet.....	17
3.3. Ksenofobia dhe Etnocentrizmi .....	18
3.4. Seksizmi, Homofobia .....	21
3.5. Racizmi dhe radikalizimi në internet .....	22
<b>Rekomandime .....</b>	<b>25</b>



*Për të gjithë ju që  
guxoni ta kundërshtoni  
gjuhën e urrejtjes  
publikisht kur të tjerët  
heshtin.*



## Hyrje

Përveç të mirave të shumta, fatkeqësisht interneti ka edhe anët e tij të errëta. Interneti nuk është vetëm platformë që afron njerëzit mes vete, por edhe hapësirë ku njerëzit sulmojnë njëri-tjetrin. Ndër problemet që shkakton bota online është hapësira që u jepet përdoruesve të gjuhës së urrejtjes. Interneti mundëson që gjuha e urrejtjes e përdorur në një cep të botës, të lëndojë dikë në një cep tjetër.

Qendra për Studime të Avancuara FIT (Qendra FIT), me përkrahje nga Agjencia Suedeze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Zhvillim dhe Fondi për Zhvillimin e Komunitetit, ka krijuar këtë broshurë për të rinjtë që të informohen në mënyrë të drejtë rreth gjuhës së urrejtjes në internet.

Broshura është realizuar në kuadër të projektit **“Mobilizimi i të rinjve për të luftuar gjuhën e urrejtjes dhe promovuar të drejtat e njeriut në internet”** dhe është e bazuar në dokumentet e shumta të Këshillit të Evropës si pjesë e kampanjës kundër gjuhës së urrejtjes. Përmes

kësaj broshure ne synojmë që t'i ndihmojmë të rinjtë sadopak të kuptojnë dhe reflektojnë mbi paragjykimet dhe sjelljet e tyre, sidomos ato në internet. Përmes broshurës, të rinjtë do të familjarizohen më shumë me termet si gjuha e urrejtjes, diskriminimi, racizmi, bullizmi në internet, ksenofobia, homofobia, e seksizmi. Poashtu, do të mund të informohen rreth të drejtës ligjore për shprehje të lirë dhe përkufizimeve të saj.

Qëllimi ynë kryesor është që t'i nxisim të rinjtë të zhvillojnë mendimin kritik dhe inteligjencën emocionale duke analizuar se si interneti ka kontribuar në rritje të gjuhës së urrejtjes dhe pikëpamjeve ekstremiste. Në fund ata do të mund të përdorin mënyra të reja për luftimin e gjuhës së urrejtjes.

Ne inkurajojmë të gjithë të rinjtë që me informacionet që do të marrin nga kjo broshurë të kontribuojnë në ndërtimin e një shoqërie më të mirë, dhe një mjedisi më të sigurt në internet.



# 1. Liria e shprehjes

Liria e fjalës dhe e shprehjes së mendimit paraqet të drejtën themelore të njeriut. Ajo luan rol të jashtëzakonshëm në mbrojtjen e të drejtave të tjera.

Është një e drejtë themelore civile dhe politike që përfshin çdo gjë nga liria e mendimit dhe liria e shprehjes së mendimit, deri te liria institucionale e mediave. Liria e mendimit është një e drejtë absolute, që do të thotë se askush nuk mund ta rrezikojë ose kufizojë të menduarit e njeriut, ndërsa liria e shprehjes së mendimit trajtohet si e drejtë politike. Kësisoj, si e drejtë politike mund të jetë edhe objekt i kufizimeve të caktuara gjithnjë në përputhje me ligjin.<sup>1</sup>

E drejta e lirisë së shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur lirshëm mendimet, pikëpamjet, idetë dhe për të kërkuar, marrë dhe dhënë informacione.<sup>2</sup>

Sipas Gjykatës Evropiane për të drejta të njeriut, “interneti është bërë tani një nga mjetet kryesore me të cilat individët

ushtrojnë të drejtën e tyre për lirinë e shprehjes dhe informimit.” Përdoruesit e internetit duhet të jenë të lirë për të shprehur bindjet dhe pikëpamjet e tyre për jetën. Liria e shprehjes vlen jo vetëm për mendime që përkujnë me ato të publikut të gjerë e që konsiderohen si të padëmshme, por edhe për ato që shqetësojnë e ofendojnë.

Sidoqoftë, ushtrimi i së drejtës për lirinë e shprehjes nga ana e përdoruesve të internetit duhet të jetë i balancuar me të drejtën për mbrojtjen e reputacionit. Udhëzuesi për përdorues të internetit nga Këshilli i Evropës specifikon se përdoruesi i internetit duhet të ketë vëmendjen e duhur ndaj reputacionit të tjerëve, duke përfshirë edhe të drejtën e tyre për privatësi kur e ushtron lirinë e fjalës.

<sup>1</sup> <https://www.osce.org/files/f/documents/0/1/116609.pdf>

<sup>2</sup> Rekomandimi CM/Rec (2014)6 i Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare mbi një udhëzues për të drejtat e njeriut për përdoruesit e internetit

## 1.1. Standardet Ndërkombëtare

Në nivel ndërkombëtar, mekanizmi më i njohur është **Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP), Neni 19** i së cilës shkruan se:



*Secili duhet të ketë të drejtën e lirisë së shprehjes*

Përveç kësaj, **Gjykata Evropiane për të Drejtave të Njeriut** ka pohuar se:



*Liria e shprehjes përbën një nga bazat thelbësore të një shoqërie të lirë, një nga kushtet themelore për përparimin dhe për zhvillimin e çdo njeriu.*

Megjithatë, Konventa ka vendosur edhe kufizime mbi lirinë e shprehjes. **Pika 3 e Artikullit 19** parasheh që:



*Kur shprehemi, duhet të ruajmë reputacionin e të tjerëve; të mbrojmë sigurinë kombëtare, rendin publik, shëndetin dhe moralin publik.*

## 1.2. Standardet ligjore të Kosovës

Për qytetarët e Kosovës, liria e shprehjes sigurohet nga akti më i lartë juridik i shtetit: **Kushtetuta e Republikës së Kosovës**.

Është **Neni 40** i këtij dokumenti ai që garanton lirinë e shprehjes.



*Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendim edhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush.*

Megjithatë, **pika 2 e Nenit 40** parasheh:



*Kufizim të lirisë së shprehjes me ligj në rastet kur ka nxitje dhe provokim të dhunës dhe armiqësi në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.*

**Neni 141 i Kodit Penal** shkruan se:



*Kushdo që nxit ose përhap publikisht urrejtje, përçarje dhe mos durim midis grupeve kombëtare, racore, fetare, etnike e të tjera, apo bazuar në orientimin seksual, identitetin gjinor dhe karakteristikat e tjera personale, në mënyrën e cila mund të prishë rendin publik dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë (5) vjet.*

**Neni 4, pika 1.4 e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi** thotë:



*Nxitja për të diskriminuar konsiderohet diskriminim mbi bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, dhe përfshin çdo promovim të urrejtjes kur ajo bëhet me dashje.*

Për ne është relevante edhe **Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore të Këshillit të Evropës nga viti 1950**, ku **neni 10** garanton lirinë e shprehjes:



*Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i pengon shtetet që ndërmarrjeve të radiove, filmit dhe televizionit tu imponojë leje për punë.*





## 2. Gjuha e urrejtjes



**Jacinda Ardern,**  
Kryeministre  
e Zelandës së Re



*“Po sikur të mos e shohim veten në bazë të dukjes, fesë që praktikojmë, apo ku jetojmë... por në bazë të asaj që vlerësojmë? Njerëzia, mirësia, ndjesia e brendshme e lidhjes ndërmjet nesh. Dhe besimi se ne jemi kujdestarët jo vetëm të shtëpisë dhe planetit tonë, por edhe kujdestarë të njëri tjetrit.”*

Edhe pse nuk ka asnjë përkufizim universal të pranueshëm të gjuhës së urrejtjes, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës ka deklaruar se termi **“gjuhë e urrejtjes”** mbulon:



*Të gjitha format e shprehjes të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen racore, ksenofobinë, anti-semitizmin ose forma të tjera të urrejtjes të bazuara mbi intolerancën, duke përfshirë: intolerancën e shprehur nga nacionalizmi dhe etnocentrizmi agresiv, diskriminimin dhe armiqësinë kundër pakicave, emigrantëve dhe njerëzve me origjinë emigrante.*

Gjuha e urrejtjes synon të poshtërojë, turpërojë ose nxisë urrejtjen kundër një individi ose grupi njerëzish. Mund të ndodhë çdokund: në shtëpi, rrugë, shkollë, vend të punës apo institucion. Poashtu, ajo është bërë e pranishme edhe në internet.

Protokolli i posaçëm për gjuhën e urrejtjes në Internet i miratuar nga Këshilli i Evropës e definon gjuhën e urrejtjes në internet si çdo:

- kërcënim të motivuar racist ose ksenofobik përmes sistemit kompjuterik
- ofendim të motivuar racist ose ksenofobik përmes sistemit kompjuterik
- mohim, minimizim i madh, aprovim ose justifikim të gjenocidit ose krimit kundër njerëzimit.<sup>3</sup>

Urrejtja mund të komunikohet në televizion, në gazeta, gjatë tubimeve publike, në shkollë, vendin e punës, apo në lagje, në rrugë ose brenda familjeve; ajo mund të shfaqet në internet nëpër uebfaqe, aplikacione, blogje, media sociale, ose në email apo biseda. Interneti mund të bëhet shumë armiqësor kur urrejtja shfaqet në video dhe fotografi, këngë, vizatime, imazhe të manipuluar e kështu me radhë. Gjuha e urrejtjes mund të komunikohet duke përdorur fjalë, simbole, imazhe, meme, emoji dhe video.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut garanton barazinë dhe mosdiskrimi-

nimin për të gjithë njerëzit. Mbrojtja e dinjitetit pa diskriminim është ajo që na mbron nga gjuha e urrejtjes. Kjo do të thotë se gjuha e urrejtjes është kërcënim për të drejtat e njeriut dhe në shumicën e vendeve format e rënda të gjuhës së urrejtjes janë të paligjshme.

Po kur shndërrohet gjuha e urrejtjes në krime të urrejtjes?

Krimet e urrejtjes janë vepra kriminale të kryera me një motiv paragjykses. Çdo krim i urrejtjes ka dy elemente:

1. Elementi i parë është kryerja e një veprë që përbën vepër penale.
2. Elementi i dytë është se shkelësi me dashje zgjodhi një shënjestër në bazë race, gjuhe, feje, etnie, kombësie ose ndonjë faktor tjetër të ngjashëm.<sup>4</sup>

Së fundi, një shqetësim i madh në internet është se grupet e urrejtjes po i përhapin ideologjitë e tyre urrejtëse në mënyra të fshehura, që nuk duken qartë si raciste. Email-et private ose mesazhet personale janë mediumi më i vështirë për tu kontrolluar ose ndikuar. Grupet e urrejtjes po arrijnë gjithashtu tek të rinjtë duke zhvilluar versione të urrejtjes në lojëra të njohura kompjuterike. Në video-lojëra, grupet e urrejtjes po krijojnë lojërat e tyre online antisemite dhe raciste për të nxitur dhunë dhe gjenocid. Një lojë të ngjajshme online, patën krijuar edhe disa të rinj serb që po kryenin krime në Kosovë.<sup>5</sup>

<sup>3</sup> Rekomandimi CM/Rec (2014)6 i Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare mbi një udhëzues për të drejtat e njeriut për përdoruesit e internetit

<sup>4</sup> Keen, Ellen, "Mapping Study on projects against hate speech online", *British Institute of Human Rights*.

<sup>5</sup> <https://lajme365.com/loja-serbe-qe-paraqet-krimet-e-kryera-ne-kosove-shqiptaret-mobilizohen-duke-raportuar-ate-per-terrorizem/>



### **Si ndikon gjuha e urrejtjes në shëndetin mendor?**

Pasojat negative për viktimat janë të shumta. Ato ndikojnë në mirëqenie më të dobët emocionale ku ndjenjat më të pranishme janë zemërimi, turpi dhe frika.

Për më tepër, viktimat kanë tendencë të përjetojnë shëndet të dobët mendor, duke përfshirë depresionin, ankthin, mekanizmat mbrojtës për shtypje të emocioneve, stresin post-traumatik dhe mendime për vetëvrasje. Këto pasojat ndikojnë në shëndet të dobët fizik, dhe stres. Këto mund të shoqërohen me përdorim të madh të alkoolit ose drogës. Gjuha e urrejtjes mund ta bëjë viktimën të ndihet në faj, t'i ulë vetëbesimin dhe njëkohësisht edhe ndjeshmërinë për viktimat tjera.<sup>6</sup>

Personi që promovon gjuhën e urrejtjes, gjithashtu mund të ketë pasojat në shëndetin e tij/saj mendor. Kanalizimi i emocioneve të ndrydhura në gjuhë të urrejtjes nuk i zgjidh problemet apo çështjet emocionale të tij/saj.

Postimet e urrejtjes mund të bëhen virale, e kjo mund të inkurajojë më shumë postime urrejtjeje.

Autorët e krimeve të urrejtjes karakterizohen me një paqëndrueshmëri të lartë emocionale. Nxitësit e mundshëm të urrejtjes janë të interesuar në dominim shoqëror, janë shumë paragjykses dhe përdorin shumë “shkurtesa” në të menduar, në vend të mendimit të mirëfillt kritik. Poashtu, mungesa e ekspozimit ndaj diversitetit mund të shoqërohet me sjellje diskriminuese apo seksiste.

<sup>6</sup> <https://www.healthaffairs.org/doi/10.1377/hpb20200929.601434/full/>



Përgatitja e shtuar mendore që duhet për t'u marrë me mikroagresionet në internet përkthehet në një stres kronik të ngritur - i ashtuquajtur "stres toksik i gradës së ulët". Në planin afatshkurtër, ngritja e nivelit të stresit e zbraz energjinë, duke na lënë të lodhur. Stresi toksik i zgjatur i shkallës së ulët, mund të çojë në rezultate të pafavorshme shëndetësore, të tilla si depresioni ose ankthi, ose dëmtime kognitive.<sup>7</sup>

### **Gjuha e urrejtjes në internet shënoi rritje gjatë pandemisë COVID-19!**

COVID-19 çoi në rritjen e niveleve të gjuhës së urrejtjes në internet.

Studimi, i drejtuar nga një kompani që përdor inteligjencën artificiale për të zbuluar dhe filtruar përmbajtjet në internet, zbuloi një rritje prej 70% të urrejtjes midis fëmijëve dhe adoleshentëve gjatë bisedave në internet. Ai gjithashtu gjeti

një rritje prej 40% të toksicitetit (sjelljeve të dëmshme) në mesin e lojtarëve të rinj që komunikojnë duke përdorur lojëra fjalësh. Pati 900% rritje të gjuhës së urrejtjes në Twitter drejtuar Kinës dhe kinezëve dhe 200% rritje të trafikut në faqet urrejtëse me postime specifike kundër aziatikëve.<sup>8</sup>

Veçanërisht vërehet ngritja e urrejtjes në TikTok gjatë pandemisë. TikTok ka qindra miliona përdorues, shumë prej tyre fëmijë dhe adoleshentë. Gjatë fazave të hershme të pandemisë, studiuesit panë një rritje të lartë në postet ekstremiste të ekstremit të djathtë, duke përfshirë ideologjitë e fashizmit, racizmit, antisemitizmit, anti-imigracionit dhe ksenofobisë.

Të qenit i ekspozuar ndaj gjuhës së urrejtjes gjithashtu i bën të rinjtë të bëhen më pak të ndjeshëm ndaj gjuhës së urrejtjes. Ata bëhen indiferentë, duke parë komentet e urrejtjes si shaka.

<sup>7</sup> <https://theconversation.com/young-people-are-exposed-to-more-hate-online-during-covid-and-it-it-risks-their-health-148107>

<sup>8</sup> [https://l1ght.com/Toxicity\\_during\\_coronavirus\\_Report-L1ght.pdf](https://l1ght.com/Toxicity_during_coronavirus_Report-L1ght.pdf)

## 2.1. 5 Arsyjet pse duhet t'na interesojë gjuha e urrejtjes

---

- 1** Sepse gjuha e urrejtjes ka rëndësi. Mbi të gjitha, historia ka treguar se mund të ketë pasoja vdekjeprurëse. Kujtoni Holokaustin, Srebrenicën, luftën në Kosovë, ISIS-in, Apartheidin në Afrikë të Jugut dhe skllavërinë e racizmin në Amerikë, si dhe qindra krime të cilave iu ka paraprirë kultivimi i pandërprerë dhe sistematik i gjuhës së urrejtjes.

---

- 2** Gjuha e urrejtjes mund të shkatërrojë jetët tona, kurse mungesa e saj krijon kushtet që ne të lulëzojmë si talente, të realizojmë potencialin tonë dhe të ndjekim aspiratat për jetë të përmbushur dhe ambiciet për karrierë të sukseshme. Gjuha e urrejtjes mund të këput në gjysmë rrugëtimin e dikujt, mund ta izolojë dikë nga të tjerët dhe t'ia pamundësojë kontributin në shoqëri.

---

- 3** Gjithashtu, gjuha e urrejtjes është e dëmshme edhe për raportet mes komuniteteve e grupeve të ndryshme në një shoqëri. Përdorimi i saj prishë harmoninë, armiqëson marrëdhëniet dhe rrënon tolerancën. Rregullimi i gjuhës së urrejtjes para se të shihet si cënim i lirisë së shprehjes, duhet të shihet si masë që mbron një të mirë publike. Secili anëtar i shoqërisë duhet të jetojë pa frikë, dhunë, diskriminim dhe poshtërim. Këto janë elemente bazike për një shoqëri të drejtë që respekton dhe mbron dinjitetin e anëtarëve të saj. Mbrojtja është një e mirë publike, pa të cilën nuk mund të imagjinohet funksionimi normal i një shoqërie.

---

- 4** Gjuha e urrejtjes e cenon “tregun e ideve”, mjedisin arsimor, idealin e barazisë – trajtimin e barabartë dhe parimin e mosdiskriminimit që janë fundamentale për çdo shoqëri demokratike: gjuha e urrejtjes nuk bart me vete domethënie tjetër përveç qëndrimit për mosbarazi esenciale ndërmjet njerëzve, ajo është një formë e përjashtimit shoqëror dhe politik, deklaratë e armiqësisë ndaj një pjese të qytetarëve në shoqëri. Gjuha e urrejtjes ka ndikim të dëmshëm mbi rendin dhe sigurinë shoqërore dhe mbi kualitetin e jetës së shoqërisë: duke i bërë anëtarët e komunitetit të viktimizuar si frikacakë, të hidhëruar dhe të dyshimtë ndaj grupeve të tjera dhe ndaj strukturës së fuqisë e cila do të duhet t'i mbronte – kjo gjuhë ka kapacitet në mënyrë serioze ta dëmtojë strukturën shoqërore dhe t'i ndajë komunitetet.

---

- 5** Interneti u shndërrua në një front për përhapjen e urrejtjes. Anonimiteti dhe mobiliteti, të cilët i siguron ky mjet komunikimi, e bëri të lehtë shprehjen e urrejtjes në një hapësirë të gjerë dhe abstrakte, e cila është jashtë fushës së aplikimit tradicional të së drejtës. Megjithatë, mesazhi i urrejtjes mund të arrijë tek miliona njerëz përmes rrjetit i cili, grupeve të ndryshme, paraprakisht të fragmentizuara u mundëson të lidhen duke gjeneruar ndjenjën e komunitetit dhe identitetit të përbashkët.



## 3. Format e gjuhës së urrejtjes

### 3.1. Stereotipet, paragjykimet, diskriminimi



*“Burrat nuk qajnë”*

*“Femrat nuk marrin vesh në futboll”*

*“Gratë nuk dinë të vozisin”*

*“Burrat duhet ta mbajnë shtëpinë”*

Këto janë vetëm disa nga stereotipet që qytetarët kanë për grupe njerëzish.

Stereotipet dhe paragjykimet janë mënyra se si e kategorizojmë botën rreth nesh. Stereotipi është një imazh ose ide për një njeri apo grup njerëzish, që është shumë e përhapur, por që është fikse dhe e thjeshtuar shumë.<sup>9</sup>

<sup>9</sup> Oxford University Press, 2014


Mund të kenë një funksion pozitiv, pasi ato na mundësojnë që të marrim shpejt vendimet.

Mirëpo, stereotipizimi nuk është gjithmonë pozitiv.

**Stereotipet** i referohen një besimi të përgjithshëm për një grup të caktuar personash. Dhe për shkak se është një përgjithësim për atë që keni përjetuar një herë ose dy herë, shumicën e kohës, është e ekzagjeruar dhe ju çon në një perceptim të shtrembëruar ose të njëanshëm të asaj se si është një person apo një grup.

**Paragjykimet** në anën tjetër janë ndjenja të paarsyeshme të frikës dhe mospëlqimit ndaj dikujt apo diçkaje. Politikanët dhe media shpesh përdorin këto stereotipe. Ata luajnë me ndjenjat negative apo frikën e njerëzve si një mënyrë të mirë për të fituar zgjedhjet apo për të shitur një gazetë.

Shpesh, stereotipet negative dhe paragjykimet manifestohen me sjellje diskriminuese ngaj një grupi të caktuar njerëzish. Evoluimi nga paragjykimet deri tek gjenocidi më së miri vërehet në piramidën e urrejtjes. Diskriminimi mund të jetë i butë, për shembull, duke injoruar dikë, duke e quajtur dikë një emër nënçmues pas shpinës së tij, ose mund të jetë ekstrem, për shembull, segregacioni, apartheidi, asimilimi dhe gjenocidi.



Tek fëmijët diskriminimi zakonisht manifestohet përmes shmangies, vrazhdësisë, thirrjes së emrave dhe, me raste, grindjet. Megjithëse diskriminimi nuk bazohet gjithmonë në paragjykime. Për dallim prej atyre që diskriminojnë në përputhje me bindjet e veta, ka të tjerë që veprojnë në emër të ndonjë institucioni ose autoriteti.

Diskriminimi është e kundërta e barazisë. Kur dikush trajtohet ndryshe pa ndonjë arsytim objektiv dhe të arsyeshëm, ky është **diskriminim**. Gjuha e urrejtjes shënjestron njerëzit si individë ose si grupe, për atë se kush janë. Ajo armiqëson, marginalizon dhe cënon dinjitetin personal, shpeshherë të atyre që veçse janë të cënueshëm në shumë mënyra të tjera. Mbani mend: Jo i gjithë diskriminimi shkaktohet nga gjuha e urrejtjes, por pothuajse e gjithë gjuha e urrejtjes bazohet në diskriminim, mbi supozimin se një person apo një grup personash janë superiorë ndaj të tjerëve.

Edhe pse çdokush mund të jetë në shënjestër të gjuhës së urrejtjes, në Evropë ekzistojnë disa grupe që shënjestrohen rregullisht, për shembull: LGBT-të, myslimanët, çifutët ose grupe të tjera fetare, gratë, emigrantët dhe minoritetet e tjera etnike, romët, njerëzit që jetojnë në varfëri, personat me aftësi të kufizuara etj. Grupet e shënjestruara dallojnë nga vendi në vend. Gjuha e urrejtjes ka pasojat të konsiderueshme dhe të mëdha mbi viktimën individuale, mbi grupin e shënjestruar dhe mbi grupet e tjera të cënueshme, por edhe mbi të gjithë komunitetin.

Pandemia e COVID-19 ka nxjerrë në pah një valë të re të gjuhës së urrejtjes, diskriminimit dhe sitgmatizimit. Në fillim të pandemisë, individët që perceptoheshin si të etnisë kineze ose aziatike, emigrantët dhe të huajt, janë fajësuar për përhapjen e virusit.

### Çfarë duhet të bëjmë?

Gjuha e urrejtjes duhet të adresohet në rrënjët e saj. Me fjalë të tjera, në nivelin e qëndrimeve dhe marrëdhënieve ndërmjet grupeve të ndryshme në shoqëri. Urrejtja lulëzon mbi qëndrimet raciste, seksizmin dhe stereotipet. Nëse nuk kundërshtohet, ajo ushqen shoqërinë, duke përforcuar stereotipet dhe duke irritur më shumë gjasat për abuzim, përfshirë në disa raste, edhe dhunën fizike. Në këtë rast të fundit, gjuha e urrejtjes mund të shndërrohet në krim të urrejtjes. Shkeljeve masive të të drejtave të njeriut, si gjenocidi dhe spastrimi etnik, gjithnjë u paraprin paragjykimi, diskriminimi, e gjuha e urrejtjes.



Sipas një hulumtimi ku janë përfshirë

**380** nxënës dhe  
**138** mësimdhënës

të shkollave të mesme,

**50% e tyre**

kanë deklaruar se janë thirrur me emra fyes dhe përqeshur nga të tjerët në baza ditore, javore, mujore apo vjetore.

### 3.2. Bullizmi në internet

Në Kosovë, **mbi 70%** e fëmijëve kanë qenë viktimë të dhunës fizike e psikologjike (KOMF). Këtë situatë e ka rënduar edhe më shumë pandemia COVID-19.

Sipas një hulumtimi ku janë përfshirë 380 nxënës dhe 138 mësimdhënës të shkollave të mesme, **50%** e tyre kanë deklaruar se janë thirrur me emra fyes dhe përqeshur nga të tjerët në baza ditore, javore, mujore apo vjetore.

**27%** kanë deklaruar të jenë shtyrë dhe penguar fizikisht së paku një apo dy herë në vit.<sup>11</sup>

Këto ngacmime, sidomos ato përmes internetit janë në rritje të vazhdueshme. Meqenëse nuk ka mburojë të plotë nga bullizmi në internet çdo përdorues i internetit është i rrezikuar nga ky fenomen.

Të qenit viktimë e bullizmit si i ri në shkollë e ngrit për **40%** mundësinë e problemeve të shëndetit mendor në moshën 25 vjeçare.<sup>12</sup>

Bullizmi i bën të rinjtë të ndjehen fajtorë sikur është faji i tyre për gjithçka; të ndihen të pashpresë dhe të ngecur sikur nuk mund të dalin nga situata; të ndihen vetëm, sikur nuk kanë askënd për t'i ndihmuar; të ndihen sikur nuk përsh-

taten me grupin shoqëror; të ndihen të dëshpëruar dhe të refuzuar nga miqtë dhe grupe të tjera njerëzish; të ndihen të pasigurt dhe të frikësuar; të ndihen të hutuar dhe të stresuar duke u hamendur se çfarë të bëjnë dhe pse po ju ndodh kjo; dhe të ndihen të turpëruar që kjo po ju ndodh.

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, bullizmi është agresioni i vazhdueshëm psikologjik/fizik ndaj një apo më shumë personash. Bullizmi përfshin çdo formë të ngacmimit, talljes, kërcënimit dhe cenimit të dinjitetit njerëzor dhe integritetit trupor të një ose më shumë individëve.

Ndërkohë, **CyberBullizmi** është ngacmim që ndodh përmes pajisjeve dixhitale, si telefonat mobil, kompjuterët dhe tabletët. Në vitin 2016, Qendra FIT në bashkëpunim me Save the Children kanë hulumtuar sjambërdhunën me 1301 fëmijë të moshës 9-15 vjeç. 30% e fëmijëve raportuan se kishin qenë viktimë e sjambërdhunës. Fëmijët që kanë qenë viktimë të sjambërdhunës qoftë vetëm një herë, kanë pasoja afatgjate. Sjambërdhuna është edhe një nga arsytet pse fëmijët nganjëherë kanë nota më të dobëta në mësim (presion psikik dhe mungesë të vëmendjes); pse ata e braktisin shkollën; dhe poashtu një nga arsytet pse

<sup>11</sup> Instituti Pedagogjik të Kosovës, 2015

<sup>12</sup> Universiteti Lancaster në Angli, 2019.

kanë probleme me shëndet.<sup>13</sup> Studentët që janë shënjestër e sajberdhunës në internet janë më të ndikuar emocionalisht, krahasuar me studentët që sulmohen fizikisht. Kjo mund të duket qesharake. Mund të pyesni se si mund të jenë kaq të dëmshme fjalët në ekran? Kjo pyetje është në të vërtetë pjesë e një pyetjeje më të madhe: si mund të dëmtojnë sulmet psikologjike më shumë se ato fizike?

Në realitet, ka shumë arsye pse sulmet psikologjike mund të lëndojnë më shumë:

- 1** sulmet psikologjike mund të jenë shumë më të gjata e pa ndërprerje sesa sulmet fizike; ato mund të vazhdojnë gjatë dhe shpesh kalojnë nga shkolla në hapësirën e internetit për të vazhduar edhe më tej.
- 2** për shkak se ato shpesh mund të bëhen përpara të tjerëve duke përdorur mjete dixhitale, që i bëjnë këto sjellje agresive e bullizuese shumë më publike.

Ky ekspozim publik mund të jetë një element kryesor i traumës së shkaktuar nga bullizmi në internet dhe, për fat të keq, shpesh përkeqësohet nga psikologjia e adoleshentëve që përjetojnë diçka të tillë. Në adoleshencë, siç e dijmë të gjithë djemtë dhe vajzat e kanë atë idenë se e gjithë bota po i shikon dhe po magjepset pafundësisht pas tyre.

Psikologët e quajnë këtë efekt “audiençë imagjinare” - sensin që ju jeni vazhdimisht në skenë, duke u shqyrtuar nga afër nga të tjerët. Kjo ndihmon të shpjeg-

gojmë se pse adoleshentët mund të refuzojnë të shkojnë në shkollë për shkak të një puçrre të vogël në fytyrën e tyre.

### 3.3. Ksenofobia dhe etnocentrizmi

“Shkoni prej nga keni ardhur”, “Virusi kinez”, “Vjedhje masive nga imigrantët” janë vetem disa nga shprehjet që i hasim në media, rrjete sociale dhe diskurs publik. Të gjitha e kanë një emërues të përbashkët- natyrën e ksenofobisë.

Kur flasim për ksenofobinë kryesisht ju referohemi qëndrimeve, paragjykimeve dhe sjelljeve që refuzojnë, përjashtojnë dhe shpesh poshtërojnë personat, bazuar në perceptimin se ata janë të huaj ose të paktën të huaj për komunitetin, shoqërinë ose identitetin kombëtar. Vetë fjala ksenofobi rrjedh nga fjalët greke xeno, që do të thotë “i huaj”, ose “i mysafir” dhe fobi, që do të thotë frikë. Pra, ksenofobia fjalë për fjalë paraqet një qëndrimi fobik ndaj të huajve. Termi zakonisht përdoret për njerëzit që kanë frikë nga emigrantët ose njerëz nga kultura të huaja, të panjohura. Ksenofobia si fobi e vërtetë, manifestohet në dy mënyra:

- 1** *Ksenofobia kulturore*- ndodh kur një person ka frikë nga një kulturë e huaj.
- 2** *Ksenofobia ndaj të huajve ose emigrantëve*- ndodh kur dikush frikësohet nga njerëzit ose grupet që perceptohen se janë të huaj.

<sup>13</sup><https://fit-ks.org/wp-content/uploads/2017/08/Raporti-Siguria-e-f%C3%ABmij%C3%ABve-n%C3%AB-Internet-2016-2.pdf>

Ksenofobia është në fakt manifestim i etnocentrizmit. Termi “etnocentrizëm” u shpik nga William Graham Sumner dhe ka të bëjë me tendencën e një personi ose një grupi për të interpretuar realitetin bazuar në parametrat e tyre kulturorë. Kjo lidhet ngushtë me paragjykimin se vetë grupi etnik dhe të gjitha karakteristikat e tij janë më të larta se karakteristikat etnike të të tjerëve.

Si të tillë, etnocentrizmi dhe ksenofobia kanë një logjikë përjashtuese, fokusi i së cilës është kryesisht në aspektin kulturor që konsiderohet disi “i ndryshëm apo i huaj”. Në këtë formë, njerëzit tentojnë të ruajnë dhe ndërtojnë kufij socialë dhe kulturorë, e kjo mund të sjellë një përjashtim të qëllimshëm ose të pavetëdijshëm të kulturave të tjera.

Ksenofobia mund të lind edhe brenda një komuniteti, i cili nuk e sheh si pjesë të veten një grup të caktuar si pakicat, emigrantët, refugjatët etj. Të huajt gjithmonë duken si të dyshimtë dhe paraqiten si sinonim i negatives. Për këtë arsye, ksenofobët manifestojnë sjellje që janë të dëmshme dhe urretëse. Këto sjellje gjejnë hapësirë në vendet ku e drejta nuk sundon mirëfilli. Në Kosovë për shembull, së fundmi, një grua nga komuniteti rom është sulmuar fizikisht në disa komuna të Kosovës nga të rinj meqë mediat rrejshëm e kishin prezantuar si keqbërëse.<sup>14</sup>

Mënyrat e shfaqjes së ksenofobisë janë nga më të ndryshmet: provokimet dhe përcmimet verbale, thyerja e rrugës kur i zë syri një të huaj, ndërrimi i vendbanimit nëse në afërsi ka të huaj, ose edhe

sulmet e dhunshme, vrasjet, dëbimet, gjenocidi, apartheidit etj. Pra, termi ‘ksenofobi’ ka konotacion të fortë politik. Rritja e migrimeve si rezultat i luftërave, mungesës së sigurisë, kriza financiare e vitit 2008 e ka ngritur proporcionalisht edhe ksenofobinë. Në SHBA, Trump u zgjodh në një valë ksenofobie ku në diskursin publik theksohej lufta kundër bandave kriminale të imagjinuara, tregtarëve të drogës dhe trafikantëve të qenieve njerëzore që supozohet se po vijnë nga kufiri me Meksikën. “Ndërto murin” është slogani perfekt i kohërave tona ksenofobe. Disa grupe politike janë mbledhur për të kundërshtuar imigracionin nga hispanikët, veçanërisht ata nga Meksika. Ky reagim shpesh herë ngjallet nga frika e humbjes së vendeve të punës dhe nga rritja e krimit. Edhe në Britani, sipas shumë analizave në media, BREXIT-i ka ndodhur pikërisht nga orvatja për ta mbrojtur vendin nga rreziqet e migrimit të lartë në vend. Në fushatën që Britania të largohet nga BE, populli u paralajmërua ashpër për kërcënimin e një fluksi të huajsh që supozohet se “po vërshonin në kufirin e fortesës së Britanisë”. Kryeministri në atë kohë e nënvlerësoi fuqinë e ksenofobisë kur supozoi se njerëzit nuk do të votonin për ta bërë vetën më të varfër vetëm pse nuk u pëlqejnë që polakët ti kenë fqinj.

Së fundmi, frika nga pandemia COVID-19 shpesh ka çuar në ksenofobi. Fakti që është vështirë të menaxhosh frikën e ankthet personale e bën më të lehtë të akuzosh të tjerët. Në rastin e COVID-19, ose koronavirusit, është rritur ksenofobia ndaj aziatikëve sidomos në formën e ngacmimit dhe kërcënimeve të dhunës.

<sup>14</sup> <https://rahopress.com/e-dhimshme-gruan-rome-e-rrahin-brutalisht-edhe-huliganet-e-ferizajt/>

## Kishte gati **3,800** raportime

të dorës së parë në vit për urrejtje anti-aziatike në SH.B.A., duke përfshirë ngacmimet verbale dhe sulmet fizike.

Guvernatori i rajonit Veneto të Italisë, një epiqendër e hershme e pandemisë, u tha gazetarëve në shkurt se vendi do të përballonte më mirë pandeminë se Kina për shkak të «kulturës së italianëve për higjienën, e larjen e duarve, ndërsa të gjithë kemi parë kinezët që hanë minj të gjallë». Përdorimi i termit «virus kinez» nga Presidenti i SHBA Donald Trump vetëm sa ka ndikuar edhe më shumë në rritjen e qëndrimeve dhe sjelljeve ksenofobe. Kishte gati 3,800 raportime të dorës së parë në vit për urrejtje anti-aziatike në SH.B.A., duke përfshirë ngacmimet verbale dhe sulmet fizike. Në Londër, në ditët e para të pandemisë, Jonathan Mok, një student kolegji nga Singapori, raportoi se ishte grushtuar dhe shkëlmuar në rrugë në Londër. Sulmuesit e tij, ai i tha BBC, bërtitën, «Ne nuk duam koronavirusin tuaj në vendin tonë.»<sup>15</sup>

Ksenofobia, edhe pse ngërthen në vete një gamë të gjerë të situatave në shoqëri, ajo kryesisht shërben si bazë ideologjike për nacionalizmin dhe për diskurset publike kundër imigrantëve. Prandaj, ksenofobia mbështet pjesën më të madhe të ideologjisë së partive politike të krahut të djathtë sidomos partive populiste që theksojnë diferencat kulturore mes të huajve dhe komunitetit të brendshëm. Ato përdorin gjithnjë e më shumë diskursin ksenofob për të “legjitimuar” politikën e tyre raciste. Sidomos

kur shtetet ballafaqohen me paqëndrueshmëri politike e ekonomike, një diskurs i ndërtuar mbi “rrezikun nga tjetri”, “planet djallëzore të tjetrit” e rrit populizmin e partive të caktuara.

Diskursi i kryeministrit hungarez Orban është shembull ideal i ksenofobisë. Ai stigmatizoi familjet rome si përtac, fëmijët e tyre si të dhunshëm, të pabindur dhe të paarsimueshëm. Ai e quajti të papranueshme që «në mënyrë që një pakicë të ndihet si në shtëpi, shumica duhet të ndihen si të huaj në qytetet, fshatrat ose atdheun e tyre. Krahas akterëve politik, rol të pamohueshëm në përhapjen e dukurive si ksenofobia, luajnë rol mediat dhe rrjetet sociale. Tashmë bota ka marrë një trajtë ndërvarësie ndaj tyre dhe shumë çështje ofrohen shpesh edhe pa ndonjë kriter vërtetësie. Shumë shpesh hasim në tituj portalesh si “Vendi po mbushet me sirianë”, “denoncime në polici për vjedhje masive nga refugjatët” etj.<sup>16</sup>

Fatmirësisht ekziston një mënyrë për të ndaluar këtë trend. Kur shoqëria është më e barabartë nuk ka pse të frikësohemi nga tjetri.

<sup>15</sup> <https://www.unicefusa.org/stories/5-days-fight-racism-and-xenophobia/34567>

<sup>16</sup> <https://rd.al/2020/06/08/vendi-mbushet-me-siriane-dhe-marokene-denoncime-ne-polici-per-vjedhje-masive/>.

më pak se **30%** e të diplomuarve në lëndët STEM në të gjithë botën janë gra. Ndërsa në Kosovë, vetëm **17%** e të punësuarve në sektorin IT janë gra.

### 3.4. Seksizmi, Homofobia

**Seksizmi** është çdo shprehje (akt, fjalë, imazh, gjest) e bazuar në idenë se disa persona, më shpesh gra, janë inferiorë për shkak të gjinisë të tyre.<sup>17</sup>

Seksizmi është i dëmshëm. Ai formon bazën e pabarazive midis grave dhe burrave dhe çon në diskriminim. Shumica e grave në një moment kanë përjetuar një akt seksist.

Vërejtje të papërshtatshme në rrugë në mëngjes, diskriminim në vendin e punës gjatë ditës, ndarje të pabarabartë të punëve të shtëpisë dhe obligimeve ndaj fëmijëve dhe më pas, në mbrëmje, gjuhë seksiste në debatet dhe emisionet televizive: seksizmi është diçka që shumë gra përjetojnë gjatë gjithë ditës e disa edhe gjatë gjithë jetës.

Seksizmi prodhon ndjenja të pavlefshmërisë, strategji shmangieje dhe vetëcensurë, ndryshime në sjellje dhe përkeqësim të shëndetit. Akte individuale të seksizmit krijojnë një klimë frikësimi dhe pasigurie, e cila mund të çojë në tolerancë të dhunës, veçanërisht ndaj grave dhe vajzave.

Në rrjetet sociale ka shumë faqe që shpërndajnë shaka seksiste. Njëra prej tyre është një fotografi e një burri me përshkrimin “Çikat e Teknikës”. Qëllimi

i këtyre personave është që të promovojnë qëndrime urretjese ndaj grave në mënyrë më të pranueshme për të rinjtë-përmes memes humoristike. Mos harroni kurrë se këto shaka mund të ndikojnë në uljen e motivimit të vajzave për të studiuar atë çka dëshirojnë ato gjë që reflektohet në numrin e ulët të vajzave në drejtimet STEM (shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë). Ky fenomen është rezultat i paragjykimeve dhe stereotipeve që kufizojnë pjesëmarrjen e vajzave në këto profesione të konsideruara “për burra”. Paragjykimet e tilla ulin vetëbesimin se do t’ia dalin të kenë një karrierë të suksesshme në fushat STEM. Edhe pse nuk ka ndonjë dallim të madh në aftësi për këto fusha midis djemve dhe vajzave, **më pak se 30%** e të diplomuarve në lëndët STEM në të gjithë botën janë gra. Ndërsa në Kosovë, **vetëm 17%** e të punësuarve në sektorin IT janë gra.<sup>18</sup>

**Termi homofobi**, i shpikur për herë të parë në vitet 1960 në Shtetet e Bashkuara, i referohet një frike ose urretjeje ndaj homoseksualitetit dhe homoseksualëve në përgjithësi. Termi përdoret në një mënyrë që vë theksin tek aspekti i “fobisë”, në kuptimin e një neverie ekstreme ose irracionale ndaj homoseksualëve dhe lesbikeve.

<sup>17</sup> Këshilli i Evropës, 2020

<sup>18</sup> <https://kosovo.britishcouncil.org/programmes/education/21st-century-schools/women-in-science/gender-gap>

Homofobia vërehet në sjelljen e rrezikshme dhe armiqësore si diskriminimi dhe dhuna. Ngjashëm me racizmin ose seksizmin, homofobia përfshin shënjestrimin e një popullate specifike të individëve me tipare të caktuara. Homofobia, ose frika nga individët lezbike, homoseksuale, biseksuale, transgjimore (LGBTI), shpesh është shtysa për diskriminim, e cila mund të shprehet përmes mjeteve institucionale ose informale.

Nëse diskriminimi homofobik është institucional, kjo do të thotë që marrëdhëniet seksuale mes personave jo-heteroseksualë të kriminalizohen ose që individëve LGBTI u mohohen të njëjtat të drejta ligjore si heteroseksualët. Diskriminimi joformal nuk sanksionohet domosdoshmërisht nga shteti por përfshin presione shoqërore ndaj individëve, sjelljeve dhe identiteteve LGBTI.

Homofobia mund të ketë **efekte** të dëmshme të homofobisë mbi individët LGBTI. Më poshtë janë disa nga efektet e zakonshme<sup>19</sup>:

- Ndjenja e turpit dhe shtypja e orientimit seksual
- Besimi i stereotipeve negative për veten
- Mohimi ose injorimi i orientimit tuaj seksual
- Të qenit viktimë e shtypjes, diskriminimit, fyerjeve, dhunës dhe abuzimit
- Depresioni dhe një rrezik i rritur i vetëvrasjes (veçanërisht tek të rinjtë)

- Rritja e stresit dhe mungesa e mbështetjes sociale. Ia vlen të përmendet “stresi i pakicave” - term ky që i referohet ankthit të qëndrueshëm kronik që njerëzit që janë pjesë e grupeve të stigmatizuara përjetojnë nga mikroagresionet, sulmet dhe diskriminimi i të gjitha formave. Ngritja e rrahjeve të zemrës, presionit të gjakut dhe prodhimi i kortizolit i evidentuar tek këta pjesëmarrës mund të grumbullohet me kalimin e kohës për të rritur mundësinë e sëmundjeve kardiovaskulare, sëmundjeve infektive, madje edhe vdekjes më të hershme.

- Ankthi social nga frika e takimit me njerëz që janë homofobikë
- Refuzimi nga të tjerët (familja, miqtë, ose bashkëpunëtorët)
- Vështirësia për të marrë shërbime cilësore shëndetësore
- Ndikimi negativ në të ardhura dhe punësim.

### 3.5. Racizmi dhe radikalizimi në internet

Besimi se një racë e veçantë është inferiore ose superiore ndaj një tjetre, dhe se tipare të caktuara përcaktohen paraprakisht nga raca e një personi, ka ekzistuar gjatë gjithë historisë. **Racizmi strukturor** është normalizimi dhe legjitimimi i një vargu dinamikash historike, kulturore, institucionale dhe ndërpersonale që në mënyrë rutinore favorizojnë një racë,

<sup>19</sup> <https://www.verywellmind.com/what-is-homophobia-5077409>

ndërsa prodhojnë rezultate anësore kronike për ndonjë racë tjetër.

Dhe sigurisht që ekziston edhe në shoqërinë tonë.

Në disa raste, manifestimet janë të dukshme.

Ne shohim pabarazi sipas racës në shkollat tona dhe në mundësitë për punësim.

**Vetëm 7%** vlerësohet të jetë niveli i punësimit të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë. Këta numra tashmë të ulët të punësimit midis RAE të marginalizuar ndoshta do të tkurren më tej pas krizës së COVID-19.

Edhe pse shumë e kanë përshkruar COVID-19 si “barazimin e shkëlqyeshëm”, ndikimet e tij nuk janë veçse të barabarta, duke ndikuar në mënyrë disproporcionale në komunitetet e marginalizuara, përkatësisht komunitetet RAE.

Komunitat me përqëndrim më të lartë të qytetarëve nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian kanë pasur një rënie nga 11% në 42% në të ardhurat e tyre burimore. Si rezultat, komunitetet RAE janë në rrezik të rritjes së varfërisë dhe pa qasje të barabartë në arsim dhe informacion.

**73%** e të anketuarve nga këto komunitete në një raport thonë se diskriminimi është një nga pengesat kryesore për punësimin e tyre.<sup>20</sup>

Këto fakte tregojnë se racizmi është një forcë e fuqishme që pengon përparimin tonë drejt drejtësisë, drejt paqes, si dhe drejt prosperitetit.

### 5 mënyra për ta luftuar racizmin në internet?

- 1** Përdore internetin për gjëra të mira.
- 2** Mos i largo nga rrjetet sociale racistë.
- 3** Në vend të kësaj, sfidoni publikisht mendimet fanatike që ata shprehin dhe bëjeni atë në mënyrë të përsëritur, sepse ndryshimi i mendjes kërkon kohë dhe angazhimi juaj në internet mund të edukojë dhjetëra vëzhgues të heshtur.
- 4** Kamera e telefonit tuaj celular është një mjet i fuqishëm në luftë kundër racizmit. Kur shihni një diskriminim racist, xhironi dhe përhapeni atë në internet (me pëlqimin e viktimës kur është e mundur). Nëse ndiheni të sigurt, afroheni me qetësi dhe zbuteni situatën, me gjuhë të qetë të trupit dhe një zë të butë.
- 5** Bashkohu në aktivitetet, protestat dhe ngjarjet ku promovohet diversiteti, barazia dhe toleranca. Fto sa më shumë njerëz me ty.

<sup>20</sup> [https://kosint2020.net/site/assets/files/1387/discussion\\_paper\\_on\\_employment\\_of\\_roma-\\_ashkali\\_and\\_egyptians.pdf](https://kosint2020.net/site/assets/files/1387/discussion_paper_on_employment_of_roma-_ashkali_and_egyptians.pdf)

## Çfarë është Radikalizimi online?

Ardhja e kulturës dixhitale u ka dhënë ekstremistëve një mjet vërtet të pas-hembullt për rekrutim. Ata tani mund të arrijnë drejtpërdrejt në shtëpitë e të rinjve dhe fëmijëve dhe t'i mashtrojnë ata me forma të ndryshme të propagandës dixhitale.

Kur sulmuesi që e identifikonte veten si ekstremist i djathtë hyri në Xhaminë Al Noor në Mars 2019, ai nuk po mbante vetëm armë zjarri. Ai ishte gjithashtu i pajisur me armën e fundit të ekstremizmit të djathtë- Një kamerë përkrenare e lidhur me një transmetim të drejtpërdrejtë të Facebook.

Qindra persona e shikuan sulmin e tij vrasës drejtpërdrejt, me shumë që komentonin dhe shpërndanin filmimet shpejt. Brenda disa orësh ishte bërë virale.

Fatkeqësisht, metodat e tij ishin me të vërtetë efektive sepse u ricikluan në këto komunitete në internet të ekstremit të djathtë si materiale propagandistike për të rekrutuar të rinjtë, sidomos ata të varur nga video lojërat e dhunshme. Meqenëse ata bënë versione të lojërave me video, ata bënë meme nga materialet e sulmuesit që i kishte postuar në internet. Dhe kjo u përdor më pas për të frymëzuar sulme të tjera.

Sulmuesi vetë ishte radikalizuar nga përmbajtja në YouTube dhe platforma të tjera në internet. Por nuk janë vetëm kanalet e mediave sociale që ofrojnë një platformë për ekstremistët. Ata gjithashtu kanë përdorur forume të lojërave në internet për të promovuar ide raciste.

Fatkeqësisht edhe Kosova është prekur nga radikalizmi. Sipas Qendrës së Kosovës për Studime të Sigurisë “Platformat online përdoren gjerësisht si një mjet propagande për të bindur të rinjtë që të mbështesin organizata si ISIS”.

Kosova fatkeqësisht ka dhënë me siguri numrin më të madh të luftëtarëve të huaj për kokë banori në Evropë për konfliktin në Lindjen e Mesme. Dy kosovarë kryen sulme vetëvrasëse në Irak, dhe disa të tjerë u ngjitën në krye të hierarkisë së ISIS-it.

Faktorët kryesor të shtytjes janë zhgënjimi me punën e institucioneve, ndjenja e izolimit, kriza e identitetit dhe indoktrinimi ekstremist, papunësia, varfëria dhe kushtet e tjera socio-ekonomike, dhe veçanërisht sistemi i dobët i arsimit. Pastaj, kemi edhe mungesën e aktiviteteve të organizuara për të rinjtë, dhe stigmatizimin shoqëror të besimtarëve konservatorë.

Interneti është një faktor shumë i rëndësishëm në këtë sferë, dhe kohët e fundit është bërë faktori kryesor në radikalizimin dhe ekstremizmin. Transmetimi i videove propaganduese nga ISIS përmes rrjeteve sociale është bërë një mjet shpërndarës i zakonshëm për rekrutimin dhe përhapjen e ideologjive ekstremiste.



## 4. Rekomandimet



Nelson Mandela (1994)



*“Askush nuk ka lindur me ndjenjën e urrejtjes ndaj një personi tjetër për shkak të ngjyrës së lëkurës së tij, prejardhjes apo fesë. Njerëzit kanë mësuar të urrejnë dhe nëse mund të mësojnë të urrejnë, ata mund të mësojnë edhe të duan, sepse dashuria vjen më natyrshëm në zembrën e njeriut sesa e kundërta e saj.”*

Në botën e internetit, promovimi i kundër narrativave është i dobishëm për t'i shmangur të rinjtë që kërkojnë përgjigje në vende të gabuara, ku mund të hasin në gjuhë të urrejtjes, ose më keq, të bëhen pjesë e komuniteteve ekstremiste ose të radikalizuara. Kur dikush radikalizohet, shpesh ai person ndjehet i përjashtuar nga shoqëria në një mënyrë apo tjetrën dhe nuk ka ndjenjë të përkatësisë për komunitetin. Prandaj, duhet t'i bashkojmë forcat për krijimin e një komuniteti ku ka hapësirë për të gjithë dhe për çdo problem - të madh apo të vogël.

Të rinjtë zakonisht nuk e shohin me sy të mirë përfshirjen e të rriturve, qofshin ata prindër ose mësuesimdhënës nëse rrezikohen nga ndonjë formë e gjuhës së urrejtjes. Ata zakonisht mendojnë se këta po provojnë t'u tregojnë atyre se çfarë të bëjnë dhe çfarë të mos bëjnë. Për t'ju shmangur rrezikut që rekomandimet të mos jenë të efektshme, krijimi i kundër narrativave me të rinjtë si pjesëmarrës aktivë duket si një zgjidhje më e mirë.

“Kush jam unë?”

“Kush dua të bëhem?”

“Çfarë mendojnë të tjerët për mua?”

“Si mund t'i ndaloj ngacmuesit?”

“Si mund ta rris vetëbesimin?”

“Pse po ndihem kështu?”

Shumica e të rinjve sot përdorin internetin për të kërkuar përgjigje për këto lloj pyetjesh. Aty, ata gjejnë faqe të llojllojshme - disa prej tyre të mira e disa të tjera të këqija dhe të pavërteta.

Bota e internetit është një arenë e vetetë. Prandaj, është në dorën e secilit të marrë pjesë në këtë betejë dhe të kontribuojë në krijimin e përmbajtjeve që promovojnë rëndësinë e shëndetit mendor, të mendimit kritik dhe të promovimit të inteligjencës emocionale. Mund të krijoni video, lojëra në internet, podcast, apo forume ku promovohen këto aftësi. Kjo do të ndihmonte në krijimin e një mjedisi të sigurt për të gjithë.<sup>21</sup>

<sup>21</sup> <https://hackinghate.eu/news/podcasts-to-promote-emotional-intelligence-and-defuse-hate-speech-among-young-men/>

## 10 Strategji nga Këshilli i Evropës

### Si ta luftojmë gjuhën e urrejtjes?

---

**1 MBANI QËNDRIM DHE BËJENI TË QARTË SE NUK PAJTOHENI:**

Tregoni se ka njerëz që nuk i tolerojnë deklaratat që promovojnë gjuhën e urrejtjes. Të rrish i heshtur mund të nënkuptojë se pajtoheni me ta dhe kështu, urrejtja vazhdon të përhapet. Nëse e njihni personin që ka përdorur gjuhën e urrejtjes, gjithnjë mund ta pyesni pse dikush duhet të thotë gjëra të tilla. Kur bën pyetje e detyronin personin të mendojë për deklaratat e veta.

---

**2 PËRDORNI GJUHË JOSULMUESE KUR REAGONI DHE MOS REAGONI NË TË NJËJTËN MËNYRË SI MESAZHI URREJTËS:**

Pavarësisht sa shumë mund ta dëshironi, mos u hakmerrni apo mos reagoni në mënyrë jo të duhur, edhe nëse situata është veçanërisht e dhimbshme. Mos e shënjestroni autorin, por përmbajtjen e deklaratës!

---

**3 TREGONI EMPATI NDAJ ATYRE QË SHËNJESTROHEN NGA GJUHA E URREJTJES:**

Tregoni se ju mendoni që gjuha e urrejtjes është e vrazhdë dhe fyese. Përveçse të tregoni mbështetje për viktimën, mesazhi juaj mund ta inkurajojë viktimën të kuptojë se nuk ka nevojë ta pranojë urrejtjen dhe mund ta raportojë tek autoritetet.

---

**4 KORRIGJONI INFORMATAT E RREME:**

Sa herë që keni hapësirë për të shtuar informacion të saktë, bëjeni këtë dhe dëshmojini me fakte pretendimet e rreme! Mund të mos e bindni urrejtësin, por mund t'i bindni lexuesit dhe dëgjuesit.

---

**5 LARGOJENI NËSE ËSHTË E NEVOJSHME:**

Pavarësisht a preferoni të përgjigjeni direkt ose jo, mundeni gjithnjë të raportoni përmbajtjen në internet si gjuhë të urrejtjes apo ta largoni postimin, sidomos në murin apo faqen tuaj. Raportojeni tek platforma në internet (media sociale, forume). Nëse nuk kanë njohuri për të, nuk mund të bëjnë dot gjë. Shmangni ripostimin, pasi kështu e popullarizoni më shumë mesazhin urrejtës dhe e bëni më të dukshëm.

**6 MOS HUMBNI KOHË NË DISKUTIME TË PAFUND:**

Shprehni mosbesimin dhe pakënaqësinë tuaj dhe qëndroni pranë deklaratave të qeta. Shkruani shkurt, por fuqishëm.

---

**7 MËSONI DHE FLISNI PËR DIVERSITETIN, BARAZINË, GJITHËPËRFSHIRJEN:**

Sa më shumë njerëz të edukohen për këto çështje, aq më shumë mund ta parandalojmë gjuhën e urrejtjes.

---

**8 DILNI VULLNETARË PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE TREGOHUNI PROAKTIV:**

Bëhuni pjesë e komuniteteve ose organizatave që promovojnë të drejtat e njeriut. Kontrolloni në kontekstin tuaj nëse ka organizata që punojnë, për shembull, për gjithëpërfshirje, vlera demokratike dhe paqe ose kundër racizmit, seksizmit dhe diskriminimit, dhe bashkohuni në përpjekjet e tyre.

---

**9 MOS HARRONI TË RAPORTONI GJUHËN E URREJTJES TEK AUTORITETET:**

Në rast se asnjë nga këta hapa nuk ndihmon dhe ju ndjeheni se ju kërcënohet siguria dhe jeta, raportojeni gjuhën e urrejtjes tek autoritetet. Qendra për Studime të Avancuara FIT me përkrahje të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Kosovë ka përpiluar një udhëzues të detajuar për të rinjtë që përdorin rrjetet sociale, në mënyrë që t'i pajisë ata me njohuri të nevojshme për të raportuar gjuhën e urrejtjes në të cilën mund të hasin. Udhëzuesin mund ta gjeni edhe në platformën tonë të internetit, më saktësisht mund ta shkarkoni duke klikuar në këtë link: [https://fit-ks.org/wp-content/uploads/2021/03/Broshura\\_Udhezues-per-raportimin-e-gjuhes-se-urrejtjes-per-web.pdf](https://fit-ks.org/wp-content/uploads/2021/03/Broshura_Udhezues-per-raportimin-e-gjuhes-se-urrejtjes-per-web.pdf)

---

**10 MOS HUMBISNI SHPRESAT:**

Rrënjët e urrejtjes janë të thella dhe të fuqishme dhe pavarësisht sa përpiqeni, rreziku për gjuhën e urrejtjes ekziston. Ajo çka është me rëndësi është që të veproni dhe të bashkoheni me të tjerë që punojnë për të njëjtën kauzë.

